

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Të shpallur në kërkim ndërkombëtar, ekstradohen nga Zvicra dhe Italia dy shqiptarët (EMRAT) - Informo hu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/te-shpallur-ne-kerkim-nderkombetar-ekstradohen-nga-zvicra-dhe-italia-dy-shqiptaret-emrat/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 12:04:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 11:59:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9a67b678c7d0258572f76359d50c11143d4046ae1b2dcc1901c2571e10afb8f
TEKSTI	6ef2dc12aad52294af7f67c1007ad3c08bfc7502857f8e086a31e06bfab7cc98
PAMJA	c110758ec0d25b6cc7aab987e13572bc5d60fc0807c5bd44076b521d39d63258

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	087ebf16445459f4b3462fa8f4ff38ccb867c205ba2b0fefa2e1ea2824e6c10c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ff908387fa0a76615844b1eb2f3b6d25afb991cdfafb8197b5cbb8a7a203d8c9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/087ebf16445459f4b3462fa8f4ff38ccb867c205ba2b0fefa2e1ea2824e6c10c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: [Home](#) » [Të shpallur në kërkim ndërkombëtar, ekstradohen nga Zvicra dhe Italia dy shqiptarët \(EMRAT\)](#)

AKTUALITET

Demo

Të shpallur në kërkim ndërkombëtar, ekstradohen nga Zvicra dhe Italia dy shqiptarët (EMRAT)

SEPTEMBER 24, 2026



Dy persona janë ekstraduar nga Italia dhe Zvicra drejt Shqipërisë pasi kërkoheshin nga autoritetet shqiptare. Ndërkohë u arrestua në Itali Erjon Zanaj me qëllim ekstradimin drejt vendit tonë.

Në Spanjë u ekstradua Alvaro Bishaj i akuzuar si pjesë e në grupi kriminal me bazë në Spanjë gjatë viteve 2019-2020.

-U ekstradua nga Italia, shtetasi Hasan Nderjaku 38 vjeç, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi GJKKO, me vendimin e datës 30.04.2025, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal". Nga hetimet dyshohet se shtetasi Hasan Nderjaku ka qenë pjesëtar i një grupi kriminal që ka trafikuar lëndë narkotike nga Amerika e Jugut drejt vendeve të Evropës, si dhe ka investuar në aktivitete të ndryshme, para të përfituara nga kjo veprimtari kriminale.

Ndaj Hasan Nderjakut u lëshua masa e arrestit me burg në kuadër të operacionit ura .

-U ekstradua nga Zvicra, shtetasi Melsjon Kolaj (Murati), 28 vjeç, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Beratit, me vendimin e datës 17.03.2025, i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprën penale "Shtërëgimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie", kryer në bashkëpunim. 28-vjeçari akuzohet se në vitin 2024, në Berat, në bashkëpunim me 2 shtetas të tjerë, ka dhunuar dhe kanosur disa herë shtetasin P. Z., për dhënien e një shume parash.

-U ekstradua në Spanjë, shtetasi Alvaro Bishaj, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Madridi, pasi autoritetet gjyqësore spanjolle, më datë 14.12.2020, kanë lëshuar urdhër arresti për të, për veprat penale "Organizata kriminale" dhe "Kultivimi i bimëve narkotike". Ky shtetas akuzohet se ka qenë pjesëtar i një organizate kriminale që ka kultivuar dhe trafikuar lëndë narkotike Cannabis Sativa, në Spanjë, gjatë viteve 2019-2020.

-Gjithashtu, u arrestua në Itali, me qëllim ekstradimin në Shqipëri, shtetasi Erjon Zanaj 40 vjeç, lindur në Vlorë, pasi në vitin 2018 është dënua me 3 vjet burgim, nga Gjykata e Vlorës, për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike". Në vitin 2015, në banesën e këtij shtetasi u gjetën të kultivuara bimë narkotike. Interpol Tiranë vijon të bashkëpunojë me Interpol Romën, për të finalizuar procedurën për ekstradimin e këtij shtetasi në Shqipëri, për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit, 2 vjet burgim.

aktualitet	arrestim	autoritete italiane	autoritete shqiptare	autoritete zvicerane	drejtësi shqiptare
Drejtësia	dy shqiptarë	ekstradim	ekstradim në Shqipëri	ekstradim nga Italia	ekstradim nga Zvicra
ekstradohen	hetim	Interpol	itali	kërkim ndërkombëtar	krim
				kronika e zezë	kronikë
					lajme
lajme Shqipëri	persona në kërkim	policia e shtetit	procedim penal	shqipëri	shqiptarët
të shpallur në kërkim	Zvicër				

Postimet e reja

Të shpallur në kërkim ndërkombëtar,...

SEPTEMBER 24, 2026

Atentat vëllait të Fabio Dushkut, tre të arrestua...

SEPTEMBER 24, 2026

Bushi për afrimet e reja të Kombëtarja U-21: Ukrain...

SEPTEMBER 24, 2026

Bankat do të financohen me kreditë e banesave,...

SEPTEMBER 24, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

ALERT në Slloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Me prani qumështi dhe gjurmë alergjenësh, patatinat VIPA të kompanisë "Pestova" në Kosovë janë bllokuar...

Kreditorët të dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznes të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Na ndiq

SHARE.



Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al, dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.